

# PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

**Për degjesën publike që do të kryejë Shoqëria Emanuel Star lidhur me ndikimet që mund të japë aktiviteti i tij pikë karburanti me pakicë në Nj. Administrative Starovë, Berat.**

## **EFEKTET MJEDISORE TË NJOHURA**

Projekti shqyrton zhvillimin e aktivitetit të depozitimit dhe magazinimit me qëllim tregtimin e të gazit të lëngshëm. Në aspektin Urbanistik, objekti respekton distancat nga objektet ekzistuese kufiri i pronës, ai i rruges, etj. Ky impiant ndodhet në një zonë industriale dume mos patur shtëpi banimi aty pranë çka e bën dhe më tëlftë funksionimin e këtij aktiviteti. Projekti është hartuar në përputhje me normativat, kushtet teknike dhe dokumentet, që janë përdorur në Shqipëri. Impianti shtrihet në një sipërfaqe prej 350m<sup>2</sup>. Instruksioni për projektimin e tubacioneve teknologjike metalike me presion Py deri në 10Mpa është si më poshtë vijon:

- Rezervuar celiku vertikal për ruajtjen e Gazit të lëngshëm me presion të avujve të ngopur.
- Furnizimi me uje, rrjeti i shpërndarjes në impiant,
- Kanalizimi, Rrjeti i jashtëm dhe pajisjet;
- Rregullat e ndertimit dhe të instalimeve elektrike;
- Instruksion për projektimin e pajisjeve elektrike, ndricimit dhe furnizimit me energji elektrike të objekteve të impiantit;
- Instruksion për montimin e pajisjeve elektrike, ndricimin, rrjetin e furnizimit me energji në zona me rrezikshmeri shpërthimi.

Projekti përmban gjithashtu edhe mbi:

- Instruksionin për projektimin dhe furnizimin me energji elektrike të impiantit
- Shkarkimin i ngarkesave elektrostatische e instalimet perkatese;
- Konstruksionet elektrostatische;
- Rregullat për sigurimin dhe shfrytëzimit të konstruksioneve elektrike;
- Ndricimin natyral dhe artificial.
- Normat e projektimit
- Kushtet ndertimore klimaterike dhe gjeoteknike;

Ku veç të tjerave jepen edhe

- Sistemet e brendshme sanitare-teknike
- Sistemi i ngrohjes
- Sistemi i automontimit


Gjate hartimit të projektit dhe zgjidhjeve teknologjike për ngritjen e bazeve, janë shfrytëzuar arritjet e përparuara të ndertimit bazave të depozitave, që sigurojnë ftesinë konkurruese, punë të sigurte dhe po avari të impiantit.

## **Karakteristikat e Objektivit**

- Objekti në studim është një impiant grumbullimi i karburantit (naftë, benzinë dhe gaz), që do të shërbejë klientëve për furnizimin, të cilat punojnë me lëndë djegëse.

- Objekti është i ekspozuar dhe i vendosur në reliev të sheshtë, në pjesën kryesore të zonës, as në tokë kullosore, as në tokë pyjore, por në tokë e planifikuar për zhvillimin e industrisë;
- Objekti lidhet me rrugën automobilistike.
- Energjia elektrike ndodhet afër objektit.

## b) Planimetria e vendndodhjes së projektit



## c) informacioni për qendrat e banuara

Projekti zbatohet në zonë industriale në Bashkinë Berat. Pranë këtij impianti nuk ndodhen shtëpi banimi aty pranë dhe funksionimi i këtij impianti nuk përbën rrezik për njerëzit. Sistemi i depozitimit e shperndarjes së karburantit, ku ngrihet në fshatin Starovë, Berat. Për këtë është shfrytëzuar një shesh në fushë në pronesi të shoqërisë, e cila duke i plotësuar të gjitha kerkesat, përfshirë dhe ato urbanistike për një

destinacion të tillë ndikon në gjallerimin e infrastruktures perkatese.

### **Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike,**

Kalibrimi i rezervuarëve ka për qëllim të merren tabela matëse, që përcaktojnë volumin e mbushjes së tyre në intervalin midis çdo centimetri. Në tabelat matëse pasqyrohen volumet e rezervuarit në m<sup>3</sup> për çdo centimetër lartësie në forme progresive. Tabelat matëse duhet të përpilohen në këtë mënyrë:

1. Për rezervuarët me volum të vogël, me mënyrën e mbushjes së rezervuarit dhe shkarkimit të ujit duke e matur atë në saktësi.
2. Me ndihmën e matësit volumor, uji hyn në rezervuar, dhe po me atë matës volumor shkarkohet.
3. Me mënyrën e matjes së plotë dhe llogaritjen e volumit të rezervuarit, duke u nisur nga dimensionet e tij faktike.

Matja e plotë e rezervuarit duhet të kontrollohet edhe me ndihmën e këtyre instrumenteve:

- shirit matës i ngushtë, me një peshë të varur në fundin e saj deri në 0,8 kg, për matjen e gjerësisë periferike e lartësinë,
- kalibër me kursorë për të matur trashësinë e fletës në llamarinës.

Matja e gjatësisë dhe përmasa të tjera bëhen jo më shumë se dy herë dhe e mesmja midis dy matjeve merret për llogaritje. Gjatë matjes së plotë të rezervuarëve vertikal prej çeliku, kryhen këto veprime:

- Matet gjatësia e periferisë së brezit të dytë të rezervuarit, lartësinë e lejuar të çdo brezi (zonë) e trashësitë e brezave të mbetur.
- Përmasat e tjera përcaktohen në mënyrë analitike.

### **Punimet Civile**

Me qëllim arritjen e niveleve me të larta, është e domosdoshme që të përcaktohen normat e pranuar në vlerat dominuese . Normat me të larta të pranuar gjenden në CUR169 (Tab 2.1

**Tabela 2.1. Udhezuesit per Projektim ne normat me te larta**

Kriteri	Normat mesatare me te larta te pranuar [l/s/m]
Siguria e Autobotit	<0.1
Siguria e kembesorit	<0.1
Siguria/stabiliteti i tubacionit	Te investigohet ne projektin e detajuar, vleresohet <30

### **Ndërtesat**

- Impianti i pompave
- Impianti i ngarkimit të autoboteve
- Godine për zyra dhe ambiente shërbimi
- Kabine gjeneratori
- Ambient të mbushjes së bombulave
- Peshorja e autoboteve

### **Pajisjet siperfaqsore**

- Kapacitet shkarkues dhe ngarkuese

- 3 cisterna në total me kapacitet 30000 litra naftë, 10000 litra benzinë dhe 5000 m<sup>3</sup> gaz.

## **Realizimi i Punimeve**

### **Projekti i impiantit të depozitave**

Ky impiant është i përberë nga 3 depozita.

### **Mjedisi pompe-kompresor**

Mjedisi pompe-kompresor është ambjenti ku vendosen pompat dhe kompresorat të cilat sherbejnë për ngarkimin dhe shkarkimin e karburantit. Ky mjedis është ndertuar me kollona metalike si dhe mbulohet me panel sanduic. Ky ambjent do të jete i tille që të jete i hapur si dhe të siguroj mbrojtjen e depozitave duke vendosur rrjete metalike për mure të tij. Në këtë ambjent kemi dhe pajisje kundra zjarrit si dhe vendosjen e sistemit te alarmit.

### **Pika e ngarkimit të autoboteve**

Ky objekt ndertohet afer impiantit të pompave dhe lejonë që të ngarkohen dhe shkarkohen autobotet. Me anë të tubave bëhet e mundur levizja e lengut për ngarkimin e depozitave dhe autoboteve.

### **Rezervuari i ujit**

Rezervuari i ujit do te jete me vellim  $V=150m^3$ . Ky është i lidhur me impiantin e M.N.Z. dhe afer ka dhe impiantin e pompave të M.N.Z. të cilat bejnë të mundur në cdo moment nga zjarret ndezja e dhe hapja e pompave. Rezervuari ka një siperfaqe 5x5m dhe thellesi  $h=6m$ . Ai ndertohet me B/A si dhe muret e tij janë me B/A

### **Gropa e mbledhjes së ujrave**

Siperfaqja e Platformes së Shkarkimit, platformës me pilota dhe asaj të ndertesave ndahet në tre zona:

- zonat e pastra;
- zonat me mundesi ndotje;
- zonat e ndotura.
- Uji nga zonat me mundesi ndotje mblidhet dhe kontrollohet.
- Të gjitha lengjet nga zonat e ndotura drejtohen drejt gropes së riciklimit. Kjo gropë vendoset në Zonen e Objekteve dhe zbrazet me një kamion me vakum i cili largonë jashte objektit për tu trajtuar.
- Permasat e gropes është 15 x 5m<sup>2</sup> me nje thellesi 2.5 m. Per hyrjen e kamioneve rezervohet një rrugë 4 x 12 m.
- Bazuar në 1% mundesi kullimi (210 mm në 24 ore), një zone rreth 200 m<sup>2</sup> mund të drenazhohet drejt kesaj grope.

## **INFORMACIONI PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME**

### **Furnizimi me uje dhe kanalizimet**

#### **Furnizimi me uje**

Furnizimi me uje te pijshem dhe per nevoja higjeno - sanitare te depozitave te produkteve te gazit, behet permes një pusi privat personal të kompanisë si dhe rrjetit qendror.

#### **Kanalizimet**

Ne perputthje me perberjen e ujrave mbledhes ne sheshin e ndertimit te objektit

parashikohen sistemet ndares dhe kanalizimet.

- ujrat e perditshme (komunale)
- ujrat siperfaqsores (te shiut)

Nepermjet kanalizimeve behet ndarja e ujrave rrjedhes (komunal) nga ato te objekteve. Ujrat rrjedhes siperfaqsores sistemohen ne kanalizime dhe grumbullohen ne nje basen ujembledhes jashte territorit te objektit. Gropa septike eshte marre me kapacitet 1,5m<sup>3</sup>, e ndertuar sipas standartit. Rrjeti kanalizimeve te ujrave te perditshme, eshte marre prej tubash asbesto-cement me diameter 150 milimetra. Ne kanalizimet e projektuar per grumtjullimin e ujrave te shiut ndalohen rrjedhjet, te cllat mund te jene te ndotur me produktet e gazit. Nxjerrja e ujrave te shiut jashte objektit behet me tubacione betoni me diameter 200 dhe 300mm. Pusetat ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave jane te realizuara me beton arme.

### **FURNIZIMI ME ENERGI ELEKTRIKE DHE NDERLIDHJA**

Pjesa elektroteknike e projektit eshte perpunuar ne baze te dhenave dhe kerkesave te detyres se projektimit dhe gjithashtu te zgjedhjeve teknike ne funksion te kategorise ndertimore. Ne perberje te pjeses elektrike te projektit perfshihen: zgjidhja e problemeve te furnizimit me energji elektrike te pajisjeve elektrike te ndricimit elektrik, te mbrojtjes nga renia nen tension, te mbrojtjes nga rrymat elektrostatische te objekteve te projektuara. Gjate projektimit jane shfrytezuar dokumentat normative veprues dhe normat nderkombetare te Komisionit Nderkombetar te Elektroteknikes (IEC).

### **Karakteristikat e konsumatorit te energjise elektrike**

Konsumatorët kryesore të energjisë elektrike, janë elektromotoret asinkron të pompave në impiant për mbushjen e rezervuarëve cilindrik vertikal të parkut me produktet e gazit dhe pajisjet e ndricimit të brendshëm dhe të jashtëm të objektit. Tensioni sekondar i furnizimit të pajisjeve të makinerive teknologjike është 0.4kv. Fuqia më e madhe e elektromotorit sinkron është ajo e pompës së mbushjes së rezervuarëve 45kw.

*Sipas shkallës së rrezikut shpërthyes dhe atij të zjarrit, pajisjet e pastrimit dhe nyjet e saracineskave teknologjike klasifikohen në objekte shpërthyes.*

### **Furnizimi me energji elektrike**

Fuqia e instaluar e konsumatoreve të energjisë elektrike :

Pompat e ujit të impiantit MKZ -	34.5kW
Pompat e gazit antidfragant 2x11kW	22kW
Kompresori gazit antidfragant	11kW
Pompa në pusin e ujit	11kW
Pompa e dushit të ujit për depozitat	7.5kW
Kompresori i ajrit	5.5kW
Tharsi i ajrit	0.4kW
Ndricimi I jashtëm	6 kW
Paneli shërbimit teknik	10kW
Zyrat dhe sistemi kondicionimit	4kW
Shuma	111.9 kW

### **Fuqia e kerkuar**

Ne proceduren e shfrytezimit teknik te fuqive motorike industrial etje, fuqia e instaluar eshte me e madhe se fuqia e kerkuar qe sherben per kryerjen e

puneve. Diferenca midis  $P_i$  dhe  $P_k$  vleresohet me korektimin e nje koeficienti  $K_r$  i cili ne rastin ne fjale e redukton fuqin ne 78.33kW. Per shfrytezimin normal te impiantit me kete fuqi te instaluar do te duhet nje gabine eTM me fuqi 250kVA/6/0.4kV .

### **Burimet e furnizimit me energji elektrik**

Energjia e nevojshme per perdorimin ne impiantin e LPG do te sigurohet nga linja ajrore e rrjetit 6kV e cila kalon anes rruges para impiantit . Nje kampat e linjes qe ndodhet para portes se impiantit te gazit eshte parashikuar qe te futet me kabel TM nen toke per arsye sigurie meqense do te kalojne autocisternat. Siç permendem edhe me siper per te siguruar nje shfrytezim normal te impiantit meqense furnizimi me energji elektrike do te behet nga rrjeti 6kV i cili nuk e ka sigurin dhe kualitetin e rrjetit 20kV ,do te instalohet ne paralel nje gjenerator 82,5kVA i cili do te hyje automatikisht ne pune menjeher kur do te kete nderprerje te energjise.

### **Rrjeti tensionit të ulët**

Rrjeti tensionit te ulet( 0.4kV/50Hz) te ushqimit te fuqis motorike , ndricimit, matjes, sigurise, zyrove dhe sherbimit do te realizohet sipas normave dhe standarteve teknike European. Per karakterin e objektit, sistemi i shperndarjes 0.4KV do te jete i formes TN-S. Krahas tij eshte parashikuar edhe mbrojtja diferenciale e linjave per te shmangur lidhen e shkendijave ne rast rrjedhje ne izolacionin e rrjetin elektrik. Rrjeti kablor do te ndertohet i mbrjtur dhe me cilesi zjarr duruese. Linjat kablore të futura neper tubat PVC, mbi trasen e te cilave do kalojne kamjona te tonazhit te madh do te futen brenda tubave betoni ose celiku me diameter 200mm deri 300 mm. Daljet e kablove ne impiantin e pompimit te gazit per shkarkimin dhe ngarkimin e autoboteve,prane depozitave dhe ne vendet e tjera me rrezik zjarri do te jene ne tuba zingato dhe tuba gome zjar duruese me skermo teli.

### **Kontrolli i parametrave teknologjike dhe komandimi i proceseve të punes**

- Krahas infrastruktures se rrjetit elektrik te shperndarjes ne objekt jane parashikuar tuba korrugat per linjat e sistemit te kontrollit te parametrave te gazit ne depozita.
- Linjat e sistemit të kontrollit parashikohen të jene të mbrojtura me shkarkues ndaj mbitensioneve te shkaktuara nga shkarkimet atmosferike.
- Komandimi i procesit te punes ne objekt, ne varesi te karakterit te tij, parashikohet te jete lokal apo i programuar.
- Ne rastin e proceseve qe lidhen me linjen e grumbullimit te ballastit apo te ujrave siperfaqesore, komandimi i pompave parashikohet nepermjet kuadrove lokale qe mundesojne punen ne menyre automatike me ane te galexhantave elektrike apo ne menyre manuale.
- Ne rastin e pompave te gazit, komandimi i tyre parashikohet i programuar nga vendi mbushjeje dhe shitjes, nga ku edhe mund te autorizohet punimi si komandin lokal per raste remonti.

### **Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike dhe ngarkesat elektrostatike**

- Fenomeni i shkarkesave atmosferike dhe elektrostatike eshte rrezik permanent dhe shume i afte te shkaketoje zjarre te fuqishme. Mbrojtja e depozitave te impianti magazinimit nga shkarkimeve atmosferike nuk kerkon perdorimin e shtizave rrufepritese mbasi trashesia e pareteve te ketyre depozitave eshte me e madhe se 4mm.

- Tokezimi i depozitave eshte parashikuar si nje konfigurim terminalesh te bashkuara ne nje system te pergjithshem tokezimi, ku eshte perfshire edhe tokezimi i kabines elektrike.
- Ky konfigurim formon konture bashkimesh te cilet reduktojne ndjeshem diferencat potenciale qe lindin ne objekt ne rast shkerkimesh atmosferike.
- Per te arritur vleren e kerkuar te rezistences se tokezimit te sistemit rrufeprites nen 10 Ohm ne kushtet e nje sheshi te ngritur me materiale inerte, impjanti i tokezimit te depozitave te gazit do te perforcohet me elektroda te zinguara dhe te gjata 3m per te arritur ne shtresat e tokes me rezistece specifike te ulet prandaj sistemi mbrojtjes nga rrufet do te behet per depozitat me sistemin e kombinuar te tokezimit.
- Shkarkesat elektrostатike lindin edhe gjate levizjes se lengjeve neper tubacione, prandaj te gjitha tubacionet, flanaxhimet ne bashkimet e tyre, etj., do te behen me urra bashkimi me saldime tel celiku me diameter 6 deri 8mm ose tel tokezimi me kapikorta duke i lidhur me rrjetin e tokezimit .

### **Ndricimi i objektit dhe nevoja te tjera**

- Ndricimi i objektit eshte parashikuar me shtylla te larta metalike zinguar 9-12m te paisura me plafonier IP55 me llampa sodjumi te presioni te larte me fuqi deri 250W-300W.
- Komandimi i ndricimit parashikohet te behet automatik me rele dhe manual nga kabina e rojes.
- Per vete lartesine e konsiderueshme te tyre, eshte parashikuar per çdo shtylle nje impjant tokezimi lokal i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe nga rreziku i tensionit te prekjes.
- Ne objekt eshte parashikuar edhe nje rrjet pikash per nevoja remonti, te formuar nga kaseta prizash industriale me shkalle mbrojtjeje IP67, si dhe kaseta furnizimi te dy portave te jashtme te objektit te mekanizuara.

### **Pajisjet e energjise elektrike**

Ne pajisjet, qe turnizohen me energji elektrike pertshihen elektromotoret e impiantit te pompave te ngarkimit, per ndricim te jashtem dhe te brendshem si dhe per nevoja te tjera komunale. Per shperndarjen e ngarkeses tek konsumatorët te tension 0.4 kv, ne project parashikohen panele te tensionit te ulet. Te gjithë elektromotoret e vendosur ne baze jane te tipit osinkron te mbyllur. Eshte parashikuar mbrojtja e motorave elektrike 0.4 kv nga rrymat e qarkut te shkurter dhe mbingarkesat, si dhe nga luhajtjet e tensionit ne rrjet. Rrjetet e linjave shperndarese te energjise realizohen me kabell bakri. Seksioni i kablllove eshte zgjedhur sipas ngarkeses se provuar per kushtet e rrymes se ngarkeses se rrjeteve të lejuara te tensionit.

### **Ndricimi Elektrik**

#### ***Ndricimi i jashtem elektrik***

Ne projekt parashikohet ndricimi i jashtem i territorit te depos se karburant te nenprodukteve te naftes. Ndricimi realizohet me prozhektore me llampa halogjene dhe llampa inkadeshente te mbrojtura, te vendosura ne shtylla prej konstruksioni metalik. Komandimi i ndricimit realizohet nga operatori direkt ne dhenien e tij te sherbimit. Rrjeti elektrik i sistemit te ndricimit realizohet me kablllo prej bakri. Seksioni i kabllit zgjidhet sipas rrymes se ngarkeses dhe renieve te lejuara te tensionit. Mbrojtja e rrjetit te sistemit te ndricimit realizohet me çkycje automatike te vendosura ne panelin perkates.

## **Ndricimi i brendshem elektrik**

Ne projekt parashikohet tensioni i rrymes se punes (-220V, -12V) tensioni i avarise (-12V) dhe tensioni i remontit per ndricimin e ambientit (-36 V). Tipi dhe vendosja e ndricuesve eshte zgjedhur ne vartesi te mjedisit rrethues, ne perputhje me kategorite e punimeve dhe kushteve pamore. Rrjeti i sistemit te ndricimit te brendshem realizohet me kablllo prej bakri. Seksioni i kabllit zgjidhet sipas rrymes se ngarkeses dhe renieve te lejuara te tensionit. Mbrojtja e rrjetit te sistemit te ndricimit realizohet me çkycje automatike te vendosura ne panelin perkates.

## **Nderlidhja**

Nderlidhja e objektit te bazes se depozitave te produkteve te karburanteve do te realizohet nepermjet rrjetit telefonik celular.

## **TEKNOLOGJIA E OPERIMIT**

- Në impiant, gazi do të sillet me autocistern me kapacitet deri 500m<sup>3</sup> gaz i lëngshëm.
- Sistemi i linjave teknologjike ndertohet konform të gjitha standarteve Europiane për impiante të tilla dhe projektuar për të shkarkuar dhe ngarkuar autocisterna (nepermjet pomp-kompresorave GL) sipas nevojës së tregut.
- Si ngarkimi dhe shkarkimi i gazit behet duke peshuar me peshore digitale autocisternen para dhe mbas perpunimit.
- Për tregetimin me bombula deri 30 l të gazit instalohet një linje zinxhir në mbushjen automatike me gaz të tyre.
- E gjithë linja në funksionin e saj është në monitorim të vazhdueshem nga instrumentat e kontrollit të presionit, temperatures, nivelit dhe sasise.
- Në perberjen e skemes së shfrytezimit teknik të impiantit për të garantuar një pune dhe sherbim të sigurt dhe pa rrezik ndertohet një sistem i kontrollit dhe i vezhgimit me sensor dhe dedektor të digitalizuar për mbrojtjen nga zjarri, rrufet dhe shkarkesat elektrostatische.
- Gjithashtu i gjithë impianti ka rrjetin e plot të tokezimit për sigurin dhe mbrojtjen në pune të personelit drejtues dhe shfrytezues, elementet sqarues teknik të se cilit do te jene ne perfshirjen e projektit elektrik.

## **Karakteristikat e produkteve të gazit që përdoret**

Në kompleksin e projektit është parashikuar marrja, ruajtja dhe shperndarja e gazit, e cila klasifikohet si leng i nxehtë dhe qe vetendizet. Një nga cilësite baze të rreziqeve nga nenproduktet e naftës, është avullueshmeria e lartë e tyre, intesiteti i së ciles varet shumë nga temperatura e lengut dhe ajrit dhe të kushteve të ndryshme te ruajtjes. Gjatë ngarkimit krijohen ngarkesa të reziqshme të energjise elektrostatische, që lidhen me shpejtesine, rnasën e lëvizjes dhe viskozitetin e tyre, madje dhe të nje sasie të vogël të ujit në gjendje suspenze, të ajrit dhe të copave të metaleve, të cilat shumë shpejt zmadhojnë rrezikun e krijimit të ngarkesave elektrostatische. Gazet ne organizmin e njeriut nepermjet ajrit, lekures dhe organeve te frymarrjes, shkaktojne helmime te forta.

## **Të dhënat dhe vëllimi i projektit**

Në hartimin e projektit teknologjik të produkteve gaz janë konsideruar:



- detyra e projektimit, e dhenë nga investitori;
- kerkesat tekniko-teknologjike, të percaktuar sipas standardeve perkatese për manipulimin e produkteve të gazit me shumicë në depon e karburantit;
- cilesitë fiziko-kimike të karburanteve;
- pervoja jone dhe ajo boterore rmbi projektimin e bazave te produkteve te naftes;

### ***Në hartirnin e projektit teknologjik përfshihen:***

- skema teknologjike, planimetria e objektit.
- skema e lidhjes së aparaturave dhe prerjet në kuotat perkatese;
- furnizimi me energji elektrike per fuqine motorike dhe ndricimin e brendshern dhe te jashtem;
- sistemi i mbrojtjes së objektit nga zjarri;
- mbrojtja e objektit nga renia nen tension, nga shkarkimet atmosferike, si dhe te mbrojtjes nga zjarri;
- projekti ndertimor i mjediseve te sherbimeve, i realizuar nga grupi i projektirneve te pjeses ndertimore.

### ***Kapaciteti dhe regjimi i punes***

Llogaritjet perkatese teknologjike te magazinimit, për ketë depo, janë berë mbi bazën e kapaciteteve depozituese të rezervuareve dhe regjimit të punes prej 365 dite në vit me një nderrese me tete ore. Remontet eventuale dhe të vazhdueshme të depove të gazit si karburant, si dhe ato në raste avarish mund të behen në vazhdim dhe pa nderprerje të shperndarjes së produktit gaz.

### ***Zgjedhja e skemes teknologjike***

Skema e magazinimit të depove është zgjedhur në baze të produkteve të gazit që depozitohen, sipas perves me vende të huaja, etj, në projektimin e bazave të tilla. Zgjedhja teknologjike është e thjeshtë, elastike dhe mjaft funksionale. Mbi bazen e skemes teknologjike është percktuar edhe skema e lidhjes së aparaturave të nevojshme. Në objekt duke respektuar të gjitha kushtet tekniko - teknologjike janë vendosur mbi tokë 5 rezervuare cilindrik horizontal. Në perputhje me detyren e projektimit, shitja për të gjithë konsumatorët, që vijnë në impiant, realizohet nepermjet mbushjes me autocistern. Për ketë qëllim është projektuar impianti i mbushjes, duke perfshire në perputhje me sasine e gazit të lëngshëm, 5 instalime mbushese me vetrjedhje. Shkarkimi i automjeteve cisterna me produktet e gazit, në impiantin e shkarkimit realizohet me vete rrjedhje, ndërsa mbushja e rezervuareve me produktet respektive realizohet nepermjet impiantit të pompimit me pompa centrifugale. Për mbrojtje nga reshjet atmosferike estokada, ku jane vendosur të montuar instalimet e mbushjes është e mbuluar me telajo të lehte prej konstruksioni metalik.

### ***Tubacionet e linjave teknologjike***

Skema e shtrirjes së tubacioneve të linjave teknologjike parashikon realizimin e operacioneve të radhes:

- Marrjen e produkteve të gazit, që vjen me automjete cistern në depo dhe dergimi i tyre në impiant pompimi në parkun e rezervuareve cilindrik horizontal.
- Marrja e produkteve të gazit me vetë rrjedhje nga rezervuaret cilindrik horizontal në estakaden e ngarkimit të autocisternave.

Nga skema e linjave të tubacioneve teknologjike parashikohet pëputhja në kohë e operacioneve në marrjen e produktit të gazit të lëngshëm dhe dergimit të tyre në rezervuaret perkates si dhe të dergimit të tyre nga rezervuaret në postet e ngarkimit të autocisternave. Montimi i tubacioneve të linjave teknologjike është mbitokesor. Tubacionet mbitokesore vishen me emalim uretan alkid me dy shtresa. Tubacionet e perdorur në të gjithë linjat teknologjike janë të klasifikuar për produkte të gazit, që transportojnë hidrokarbure me pike flakerimi nga 30 C deri ne 100 C, që i pergjigjen gazit, etj. Gjithashtu, tubacionet e perdorur jane klasifikuar për regjim konstant shfrytezimi, me parete të pandryshueshme, me regjim izotermik shfrytezimi dhe për presion 10 MPA. Diametrat e tubacioneve të linjave teknologjike janë percaktuar me metoden e llogaritjeve hidraulike.

## **TRANSPORTI**

### **Plani i pergjithshem dhe kompozimi i objektit**

Në kompozimin e objektit janë konsideruar skema e lidhjes teknologjike të aparaturave të depove të gazit si dhe mundesite e dhena nga sheshi i ndertimit. Nga detyrat me te rendesishme të grupit të projektimit në hartimin e projektit ka qenë harmonizimi i pajisjeve dhe aparaturave për një shfrytezim maksimal të siperfaqes së sheshit. Mbi keto synime është realizuar shtrirja në plan dhe në lartesi i objektit, të paraqitura keto në pjesen grafike përkatese.

### ***Transporti i brendshem***

Rruget automobilistike në territonn e impiantit janë projektuar duke marrë parasysh shtrirjen e mjeteve teknologjike si dhe organizimin e sherbimit të mbrojtjes kundra zjarrit të objektit. Ata sigurojne lidhje të domosdoshme midis ndertesave të objektit në teresi. Rrjeti i rrugeve automobilistike është parashikuar sipas skemes me hyrje dhe dalje të sigurte për të kryer transportin e nevojshem të ngarkesave në vazhdimesi. Në rruget me ngarkesen me të lartë janë ato të sektorit të hyrjes dhe në impiantin e mbushjes së autoeisternave. Gjeresia e kalimeve të pjeseve të rrugeve kryesore është marre 6 metra. Profili horizontal i të gjithë rrugeve autornobilistike përbehet nga një shtrese dyfishe asfaltobetoni.

## **MBROJTJA E OBJEKTIT**

### ***Mbrojtja nga renia nen tension***

Keto objekte per vete karakterin qe kane duke trajtuar me shumice produkte te naftes, te veçorive teknologjike dhe rrezikshmerise qe paraqesin ne mundesine e lindjes se zjarrit, projektohen me mbrojtje të makinerive e pajisjeve nga renia nen tension. Tokezimi i pajisjeve dhe makinerive elektrike realizohet me lidhjen e korpuseve metalike komplekse, qe kane ne perberjen e tyre elektroda metalike te lidhura midis tyre me shirit metalik. Per modilikimin e pajisjeve elektrike, shfrytezohen nulet e kabllloove ushqyes. Vlera e rezistences ne kalimin e rrymes nuk duhet te kaloje:

- për impiantin e motogeneratorit diezeL 40hm
- për impiantin e mbushjes (estakaden) 120hm
- për rrufepritesit dhe rezervuaret, 50 ohm

Për mbrojtje nga fenomenet sekondare të prurjeve të potenciale te larta, korpuset metalike te saracineskave, bashkohen me konstruksionet e tokezimeve me rezistencen e rrymes se kalimit, jo me shume se 50 ohm.

### **Mbrojtja nga ngarkesat elektrostatike**

Gjithashtu, duke patur parasysh dhe mundesine e pashmageshme te lindjes se rrymave elektrostatike gjate levizjes se lengut (produktit te naltës) neper tubacione, rezervuare etj, gjate proceseve te ngarkimit e shkarkimit, dukuri kjo e rrezikshme per lindjen e vatrave te zjarrit. ne projekt jane marre masa per evitimin e pasojave.

*Mbrojtja nga rrymat elektrostatike te tubacioneve te linjave teknologjike te projektuara, realizohet nepermjet lidhjeve te konstruksioneve metalike te tyre tek pajisjet e sistemit te tokezimit. Rezistenca e kalimit te rrymes, jo me shume se 100 ohm.*

### **Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike**

Ne kuadrin e mbrojtjes se objektit nga mundesia e lindjes se zjarrit, eshte parashikuar edhe mbrojtja e tij nga shkarkimet atmosferike. Te gjithë objektet, si rezervuaret cilindrike horizontal dhe ato me lartesi te madhe te ndodhura brenda territorit te sheshit te objektit te ndertuar, si shtyllat e ndricimit me prozhektor dhe ato te furnizimit me energji elektrike perfshihen ne sistemin e mbrojtjes nga renia nen tension. Mbrojtja e rezervuareve realizohet me instalime te vedosura ne rezervuare. Impianti i mbushjes se autocisternave per mbrojtje realizohet me tokezimin e konstruksionit metalik.

### **Mbrojtja kunder zjarrit**

Mbrojtja e produkteve të gazit në parandalimin e rrezikut të zjarrit është realizuar kryesisht nepermjet hartimit të nje projekti, duke zbatuar me saktësi dhe korrektesë te gjitha normat dhe kushtet e miratuara ne drejtim te mbrojtjes ndaj kesaj dukurie. Ne projektin e zbatimit te zones teknologjike, ndertimore dhe instalatore (hidraulike dhe elektrike) konform normave dhe kushteve teknike te miratuara te projektit eshte siguruar:

- Pozicioni i vendosjes së objektit është zgjedhur i tille qe te jep mundesi afrimi te pershtatshem per shuarjen e zjarrit. Te krijon mundesi largimi në rast zjarri si dhe nuk ve ne rrezik objektet e tjera te depos dhe te atyre jashte saj.
- Rruge kalimet e hyrje – daljes, si dhe ato brenda për brenda objektit me gjeruesinë dhe shtrirjen e forte të tyre prej betoni të krijon mundesine për të afruar mjetet dhe pajisjet levizese kundra zjarrit për të patur një perdorim efikas e të sigurt të tyre kudo që shfaqen, etj.
- I gjithë ambienti është i pajisur me impiantin e shuarjes së zjarrit impiantar me gaz karbonik, për shuarjen e zjarreve në rezervuare dhe në hapsirat ndermjet rezervuarit dhe kemishes së betonit. është parashikuar vendosja e 4 fikseve me rrota me kapacitet 50 litra si edhe 8 fikseve portative me pluhur me kapacitet 50 litra.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E M.Z.SH. BERAT

Proces-Verbal

Lenda Mbi kryerjen e trajnimit per Mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin te Punonjesve te

Per zbatimin e ligjshmeris te normave e rregullave te sigurimit te jetes se njerezeve, te prones nga rreziku i zjarreve

Ne baze te ligjit nr.152/2015 dt 21.12.2016 per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin neni 48 pika c . kryej kete trajnim ne objektin. EMIGJUREL - STAR

I mbajtur sot me dt - 03.11 2016 ne objektin EMIGJUREL - STAR  
Nga Drejtori i m.z.sh. Berat nen/komisar Luman Spathara  
Sipas listes se meposhtme emerore nga ora 16<sup>00</sup> deri ne oren 17<sup>00</sup> u krye trajnimi per Mbrojtjen nga zjarri dhe per evakuim ,  
Trajnimi u be mbi bazen e nje programi ku ra dakort nga dy palet konkretisht;

1-Djegja,fazat e saj,faktoret e djegjes lendet e djegeshme fazat e djegjes te lendeve te ndryshme,zonat e djegjes.

2-Klasifikimet e zjarrit koha e zhvillimit djegjes e perhapjes se zjarrit si dhe evakuimi

3-Shkaqet e renies dhe perhapjes se zjarreve masat parandaluese

4-Lendet menytrat dhe mjetet e shuarjes se zjarrit.

5-Struktura perberse e fiksave te zjarrit hidranteve zjarrfikes te brendshem dhe te jashtem etj.

6-Menyra e perdorimit te hidranteve zjarrfikes,sistemeve te shuarjes zjarrit dhe fiksave te zjarrit.

1. Petro Zehaj

2. Ilir Zehaj

3. Mirush Zehaj

Drejtori i M.Z.SH-se Berat  
Nen/Komisar Luman Spathara

*Luman Spathara*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E M.Z SH-se BERAT

---

Ne baze te ligjit nr 152/2015 date 21.12.2015 te M.Z.Sh-se neni 48 pika C ku citohet; oganizon, ispekton dhe jep asistence teknike per zbatimin e ligjshmeris, te normave e te rregullave per sigurin e jetes se njerezve, te prones, nga rreziku izjarrit.

Program i trajnimit te punonjesve per te gjithë subjektet private dhe shteterore

Leksion dhe veprime praktike te M.Z.Sh-se ne kete program

Drejtori i M.Z.Sh-se Berat  
Nen/komisar Luman SPATHARA

## Program i trajnimit

Ceshtjet qe do te trajtohen

1-sistemi i siguris per subjektin ku perfshihen te gjitha elementet e projektit

2-Vlersimi i rrezikut te zjarrit

3-Djegja dhe produkti i saj

4-Llojet e lendeve djegese

5-Aktiviteti dhe masat per parandalimin e zjarrit masat parandaluese dhe mbrojtese

6-Ruajtja dhe perdorimi i materialeve te ndezshme dhe lehtesisht te djegeshme

7-Kontrolli mbi masat mbrojtese kunder zjarrit

8-Pajisjet dhe impiantet per mbrojtjen nga zjarri


Praktike ;ekzaminimi dhe sqarime mbi impiantet dhe pajisjet kryesore per shuarjen e zjarrit

Ushtrime mbi perdorimin e pajiseve per shuarjen zjarrit

PLani i emergjences ; Veprimet qe puntoret duhet te kryejne ne rast zjarri

Trajnuesi Drejtori i M.Z.Sh-se Berat

Nen/komisar Luman SPATHARA



Parku i rezervuareve të depozites, në teresi është kompesuar duke respektuar me korrektesi normat teknike të mbrojtjes kunder zjarrit, pra me probabilitet të vogel të lindjës së zjarreve. Të pestë rezervuarët të vendosur në skemen teknologjike janë ndertuar me konstruksion metalik, dhe rrethohen me mur betoni ne lartesi h=1m. Sheshi i tyre është me një shterse betoni prej 15cm me zgara hekuri. Bazamentet e depozitave ndertohen me pilota ku do jene tre cifte pilotash, ku nje cift pilote do jete per nje kembe metalike ose betoni per pilotat. Betoni qe do tëëë perdoret per te ndertuar bazamentet do jete i markes M350 per arsye sepse jane ndertime speciale. Hapësira e krijuar dhe e ventiluar ne menyre natyrale, ndermjet pareteve konstruksion metalik te rezervuarit dhe kemishes se betonit me gjeresi prej 800mm, krijon kushte te favorshme, per te mbajtur te fresket mjedisin perreth rezervuarit ne cfaredo periudhe te vitit si dhe për cdo mundesi lindje zjarri perreth.

Gjithashtu, konstruksioni i zgjedhur nga ana teknologjike, ka diktuar qe nder menytrat e perdorura ne sistemin e mbrojtjes kunder zjarrit, te realizohet ajo me gaz karbonik. Me ane te tubocioneve unazore te sistemit te shuarjes se zjarrit te vendosur perreth rezervuarit dhe hapësires se krijuar nga kemisha e betonit, gazi karbonik qe vjen nga mjedisi i bombolave, dergohet brenda ne rezervuar, si dhe ne hapsiren perreth rezervuarit nga jashte. Kjo krijon mundesi te shuarjes se zjarrit, si brenda ashtu dhe per cdo eventualitet jashte rezervuarit. Gazi karbonik sigurohet nepermjet vendosjes se 40 bombolave me kapacitet secila 40litra dhe presion 90kN, te lidhur ne para lei ndermjet tyre. Gjithashtu, mjedisi i bombolave te gazit karbonik ndodhet ne nje distance te konsiderueshme sipas normave edhe nga rezervuari me i afert.

*Konstruksioni i zgjedhur krijon nje izolim te kenaqshem te tyre dhe shmang vendosjen e impiantit te sistemit te freskimit te rezervuareve, per cfaredo mundesi te rritjes se temperatures ne mjedisin perreth.*

#### **Ndikimet në popullsi**

Ndikimi në popullsi mund të jetë i formave të ndryshme, gjatë kryerjes së punimeve dhe gjatë funksionimit të impiantit aksidentimi i banorëve nga mjetet e transportit në rrugë, aksidentimi i punëtorëve gjatë punës është një nga rreziqet kryesore sidomos nëse ata janë të pa trajnuar.

Lloji i ndikimit në shëndetin publik	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve			x	
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik			x	

#### **Ndikimet në Pejzazh**

Nuk ka ndikime në pejzazh, sepse zona në të cilën ngrihet Impianti është një zonë industriale. Kjo zonë do të ketë ndikime të pjesshme, gjatë periudhës së funksionimit. Pejzazhi nuk do të ndryshojë disi, pasi nuk do të ketë punime, me pluhura të shumta, që do të ngrihen. Mbetjet e ngurta, që do të dalin nga Impianti do të mblidhen përkohësisht në një shesh, në mënyrë që të jenë të gatshme për tu tërhequr nga komuna.

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime topografike të terrenit				x
Prishja e tokës bujqësore				x

Ndotja e tokës nga rrjedhjet				x
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta				x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave				x

### **Ndikimet nga Shkarkimet në Ajër**

Ndikime në shkarkimet në ajër mund të vijnë, si nga PM10 dhe nga ngarkesat gjatë qarkullimit të automjeteve, ashtu edhe nga rritja e lëvizjes së mjeteve të motorizuara dhe të rënda. Shkarkime të tjera të gazta si djegie karburantesh etj., nuk do të ketë nga ky aktivitet, për faktin se nuk do të ketë derdhje karburantësh dhe lëndë kimikatesh.

Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndotja e ajrit			x	

### **Ndikimet e zhurmave gjatë punës**

Dihet që gjatë funksionimit të impiantit do të kemi rritje të nivelit të zhurmave si pasojë e funksionimit të Impiantit dhe aktivitetit të makinave. Ndikim të madh këto zhurma do të kenë mbi njerëzit, që do të punojnë në zonën e Impiantit dhe banorëve përreth, por me masat zbutëse që do të merren nga Kompania, ato do të minimizohen. (shih Kap e uljes së ndikimeve në mjedis).

Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave			x	
Rritja e nivelit të zhurmave, si rezultat i aktivitetit dhe makinave			x	
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit				x
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët				x

### **Ndikime në transport**

Do të ketë ndikim në rrugë, sepse do të shtohet aktiviteti i makinave, kur bëhet asfaltimi i rrugës lokale dhe nga shoqëria investuese do të merret përsipër shtrimin e një pjese të rrugës.

Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve				x
Pakësime të vendqendrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendime të reja				x
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit				x
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve				x

### **Ndikime në rrugët lokale**

Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik			x	
Energji elektrike			x	
Sistemin e komunikacionit				x
Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza dhe të				x



bardha				
Sistemin e ujës-jellës				x
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre				x

### **Ndikimet në Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjike**

Ndikime në këtë aspekt nuk do të ketë, pasi në zonën e ndërtimit të impiantit dhe në zonën përreth nuk ka zona me trashëgimi kulturore dhe arkeologjike. Ato ndodhen mjaft larg ndërtimit të impiantit kështu nuk rrezikohet as prishja apo gëryerria e këtyre pasurive të çmuara.

Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore				x

### **Ndikimet në Florë e Faunë**

Zona në të cilën do të ngrihet impianti është një zonë e varfër përse i përket florës dhe faunës.

Lloji i ndikimit në florën dhe faunës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore				x
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit				x
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zones së virgjër				x
Përçarje apo izolim të habitateve të egra				x
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisorëve				x

### **Ndikimet në ujë**

Lloji i ndikimit në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujrave të ndotur			x	
Ndotja e ujit prej pluhurit, hidrokarbureve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera			x	
Ndikimi sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore, etj.			x	
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore				x
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat				x

### **Ndikimet në klimë dhe ajër**

Ndikimet në klimë nuk do të ketë, sepse nuk do të prodhohet CO<sub>2</sub> dhe sasia e çliruar e tij prej disa mekanizmave do të jetë minimale ose e pa përfillshme.

### **Ndikimet në tokë**

Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrim banesash				x
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës				x
Rivendosje banesash				x
Shpronësime të tokës				x

### **Ndikime dytësore që lidhen me projektin**

Identifikimi i ndikimit			

Lloji i ndikimit në energji	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji				x
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistues të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë				x

## NDIKIMET POZITIVE TË PROJEKTIT

### Ndikimet Pozitive

Edhe pse është e pa evitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që:

- të ketë punësim të vazhdueshëm;
- të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;
- të krijojë të ardhura të konsiderueshme financiare dhe ekonomike në rajonin në tërësi;
- ndikimet mjedisore që identifikohen të eliminohen, reduktohen ose zbuten.

Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë “ndikim fatal”, ndonëse ekzistojnë disa ndikime jo të vogla negative, të cilat do të kontrollohen nga masat zbutëse inxhinierike dhe nga ato të lidhura me sheshin

1.fazat	2. përfitime të drejtpërdrejta të komunitetit	3. përfitime të tërthorta të komunitetit.	4. konsumatori.	5.infrastruktur a
Ndërtimi i kompleksit	Punësim i 2-3 punëtorëve.	Zbutja e papunësisë dhe përmirësimi i standartit të jetesës	Administrim dhe shfrytëzim i tokës	Plotësimi me të gjitha infrastrukturë urbane
Shërbim cilësor në mjediset e kompleksit	Punësim për kryerjen e këtij shërbimi.	Zhvillimi i shërbimeve të sektorit privat në zonë	Përdorimi i gazit natyror të lëngshëm në standartet ndërkombëtare	Përmirësim i infrastrukturës rrugore

Duke patur parasysh vlerat jo të mëdha të territorit në gjëndjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, përmirësimet në infrastrukturë marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin e rajonit. Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

### Oraret dhe ditët normale të punës për kryerjen e operacioneve gjatë një jave.

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

#### Përshkrimi:

- Instalimi dhe aktivitetet e tij;
- Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;
- Burimet e shkarkimeve nga instalimi;
- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;
- Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;
- Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;
- Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;
- Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);
- Masat për përdorimin efiçent të energjisë;
- Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:
  - a) janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
  - b) janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjëndje të kënaqshme
- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Informacioni i mësipërm duhet të përfshihet në **Aneksin 14**.

### Vëzhgimi (Monitorimi)

#### a. Plani i vëzhgimit

Monitorimi është procesi i vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave në mënyrë periodike ose të vazhdueshme mbi fenomenet natyrore që zhvillohen në objekt, si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë së mësipërme.

Për realizimin e monitorimit, personat fizikë dhe juridikë specializojnë punonjës të tyre ose kontraktojnë me institute të specializuara. Vetmonitorimi i veprimtarisë realizohet në bazë të programit individual të monitorimit dhe në përputhje me kërkesat e Programit Kombëtar të Monitorimit.

Programi i vetmonitorimit të subjektit duhet të trajtojë çështjet e mëposhtme:

- Monitorimi i ndotjes akustike si pasojë e zhvillimit të aktivitetit periodikisht.
- Monitorimi i cilësisë së ujrave për parametrat e sipërcituar të kryhet çdo 3 muaj
- Monitorimi i cilësisë së ajrit për parametrat e sipërcituar të kryhet çdo 3 muaj.
- Monitorimi i ndikimeve të veprimtarisë në mjedisin përreth dhe elementë të tij.
- Monitorimi i mënyrës së zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

Monitorimi të kryhet nga laboratorë të spcializuar dhe akredituar sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Parametrat që do të monitorohen:

1. Gjendja shëndetësore e punonjësve:
  - i. Numri i ditëve me raport për shkak të sëmundjeve profesionale
2. Sasia në masë dhe vëllim të mbeturinave mujore:
  - i. letër
  - ii. plastike
3. Sasia e energjisë së harxhuar mbi baza mujore:
  - i. Korrent
  - ii. Sasia e karburantit të gjeneratorit
  - iii. Sasia e karburantit të përdorur nga makinat e transportit të mallrave
4. Sasia e ujit e konsumuar mbi baza mujore:
  - i. Ujë për procesin teknologjik të larjes
  - ii. Ujë për konsum për punonjësit
5. Niveli i ndotësve në ajrin e mjedisëve të brendshme:
  - i. PM10
  - ii. PM2.5
  - iii. Pluhur total

Monitorimet do të kryhen nga vetë investitori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimet e monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si ARM-ja e Shkodrës /Ministri e Mjedisit.

## **PËRMBLEDHJE TË KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI, PA SPECIFIKUAR DETAJET TEKNIKE**

1. Vend-ndodhja e zgjedhur në Bashkinë Berat, është një zonë industriale , pronë e shoqërisë, me sipërfaqe 350 m2.
2. Impianti furnizohet me lëndë të para të naftës, benzinës dhe gazit që sigurohet në brenda dhe jashtë vendit.
3. Ndikimet e mundshëm pozitivë dhe negativë të projektit të propozuar janë identifikuar dhe matur në masën më të konsiderueshme të mundur.
4. Sipërfaqja e përgjithëshme që përdoret është rreth 350m2. Në zonën që ngrihet impianti ka pak bimësi dhe ajo që ndodhet aty është kryesisht e ulët.
5. Zona në studim ka të zhvilluar litofacion me zhavore deri ne thellësinë 10m dhe atë argjilo ranor me poshte.
6. Ky raport vlerësimi ka për qëllim, analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisorë, dhënien e masave zbutëse si për reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton për përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis.
7. Në këtë studim identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut.
8. Në zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe në bazë të ligjeve ekzistuese të Mbrojtjes së Mjedisit, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit në 2002, riformuluar përsëri në vitin 2011 dhe Ligjit “Për Lejet e Mjedisit ”2011, i ndryshuar, ky studim synon të japë informacionin e nevojshëm për vendimmarrësit, për dhënie të lejes së mjedisit.

1. Zona në studim ka të zhvilluar litofacien me zhavore deri në thellësinë 10m dhe atë argjilo ranor me poshte.
2. Ky impiant, objekt i këtij raporti nuk prodhon lëndë të dëmshme për mjedisin, nëse merren masa kompesuese.
3. Mbetjet bashkiake që do të prodhohen nga njerëzit dhe ambalazhet do të jenë minimale.
4. Nuk ka vibracione, nxehtësi, rrezatime që mund të shkaktojnë dëmtime në punonjësit dhe banorët përreth zonës.
5. Produkti që do të përdoret për larje, është uji që vjen nga magjistrali kryesor dhe nga pusi që ndodhet në objekt.
6. Profilaksia më e mirë për shmangien e dëmtimit të shëndetit të punëtorëve është kontrolli i shërbimit shëndetësor.
7. Përfundimisht, kjo qendër për shpërndarjen e karburanteve me kushtet ekzistuese që ka, plotëson kushtet edhe si pikë shitjeje me shumicë, natyrisht duke marrë masat plotësuese nga ana e kësaj kompanie për eliminimin e rreziqeve sado të vogla.
8. Raporti është përgatitur në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe me kërkesat e sotme të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare dhe standartet e aplikueshme të Bashkimit Europian.
9. Në hartirnin e projektit teknologjik përfshihen skema teknologjike, planimetria e objektit; skema e lidhjes së aparaturave dhe prerjet në kuotat perkatese; furnizimi me energji elektrike për fuqine motorike dhe ndricimin e brendshern dhe të jashtem, si dhe të mbrojtjes nga zjarri si dhe projekti ndertimor i mjediseve të shërbimeve, i realizuar nga grupi i projekteve të pjesës ndertimore.
10. Impianti magazinimi i lenget si kapacitet total shpërndahet në tre depozita gjithsej me kapacitet total 30000 litra naftë, 10000 litra benzinë dhe 5000 m<sup>3</sup> gaz.
11. Pozicioni i vendosjes së objektit është zgjedhur i tillë që të jep mundësi afrimi të pershtatshëm për shuarjen e zjarrit. Të krijon mundësi largimi në rast zjarri si dhe nuk ve në rrezik objektet e tjera të depozitave dhe të atyre jashtë saj.
12. Konstruksioni i zgjedhur krijon një izolim të kënqshëm të tyre dhe shmang vendosjen e impiantit të sistemit të freskimit të rezervuarëve, për çfarëdo mundësi të rritjes së temperaturës në mjedisin përreth.
13. Aktivitetet në dobi të një zhvillimi të qëndrueshëm janë Asfaltimi i rrugës, brenda dhe jashtë impiantit, Gjellbërimi i zonës përreth pikës së Impiantit, Shërbimi në ambjentet e impiantit të karburant; Kontrolli dhe furnizimi me ujë industrial, Mbrojtja në punë sipas rregullave të teknikës së sigurimit dhe Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve përkatëse
14. Projekti do të bëjë që të ketë punësim të vazhdueshëm dhe të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;
15. Derdhja e ujrave të larjes apo të mbeturinave të lubrifikanteve të motorrave, mund të krijojnë kushte për ndikime të tjera, objekt i të cilave të jetë uji nëntokësor.
16. Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitetin nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin.
17. Përreth sheshit, për të siguruar një mjedis të pastër pa probleme për personelin e shërbimit, parashikohet një sistem kanalizimesh, e grumbullim sterilash, të cilat, në bashkëveprim, do të orientojnë ujërat teknologjike dhe ujërat natyrore për të vazhduar më tej me procesin e trajtimit të ujërave industriale deri në përgatitjen e tyre për shkarkim në lumin, sipas parametrave të KE. Këtyre masave parandaluese për mbrojtjen e mjedisit do t'i shtohet dhe sistemimi i vendeve të lira, duke i punuar e duke i kthyer ato zona të gatshme për zhvillim industrial.
18. Llojet, sasitë, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një rregjistër dhe për më tepër punëtorëve do t'u kërkohej të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave.
19. Evitimi ose parandalimi Parandalimi i ndikimeve negative është opsioni i parë dhe më i miri, në rast se është në linjë me qëllimet e tjera të programit të propozuar.
20. Reduktimi ose korrigjimi Reduktimi i ndikimeve negative është metoda më e zakonshme. Dëmtimi në mjedis mund të jetë i pranueshëm, por kur mbahet brenda kufijve të pranueshëm. Korrigjimi i ndikimeve negative kryhet pasi kanë ndodhur ndikimet, për shembull rimbjellja e vegetacionit të dëmtuar.
21. Kompensimi ose shlyerja e ndikimeve përfshin krijimin e një përfitimi mjedisor i cili kompenzon për një dëmtim tjetër mjedisor. Kompensim do të jetë brezi i pyllit rreth e qark veprës dhe një sipërfaqe tjetër prej një hektarësh me pyll, sa trefishi i tokës së zënë bujqësore.

22. Vlerësimi i masave për zbutjen e ndikimeve negative të zhurmave dhe dridhjeve mundet të bëhet me anë të metodologjisë krahasimore të kryer për impiante të ngjajshme dhe me të njëjtat kërkesa, si brenda vendit dhe jashtë saj, ku jepen për secilin rast ndikimi masat zbutëse si:
  - a. Lidhur me faktorët në varësi të mjeteve të transportit, e vetmja zgjidhje për këto raste është kufizimi i shpejtësisë dhe lejimi i automjeteve me gjendje të mirë në respekt të normave të kontrollit fizik.
  - b. Lidhur me faktorët mjedisorë, masa më praktike është linjëzimi me mure betoni rreth e qark veprës dhe pemë të larta e të dendura si brez pranë tij.
  - c. Projektimi i sipërfaqes së jashtme dhe mirëmbajtja Përdorimi i asfaltit “open-graded” në vend të rregullimeve të thjeshta mbi sipërfaqe mund të jetë gjithashtu i dobishëm në zvogëlimin e zhurmave të fërkimit.
23. Ulja e intensitetit të ndotjes së ajrit nga çlirimet hidrokarbure do të jetë si hapjen dhe pastrimin (mirëmbajtjen) e kanaleve kolektorë, gjatë gjithë gjatësisë përreth objektit (anash dhe lartë) për moslejimin e hyrjes së rrjedhjeve ujore e të ngurta masive në territorin në shfrytëzim dhe daljen prej tyre drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e ujrave sipërfaqësore. Thellësia e kanalit të shkarkimit të ujrave plotëson kushtet e projektit dhe pendenca e tij është në funksion të topografisë së zonës.
24. Masat që duhet të merren gjatë punës për zvogëlimin e humbjeve janë si Respektimi i hermetizimit të plotë të konstruksionit të rezervuarit, Zvogëlimi i hapësirës gazore dhe zvogëlimi i amplitudës së luhatjes të temperaturës në rezervuarin e produktit, Minimizimi i humbjeve nga avaritë e ndryshme, Kontrolli i vazhdueshëm për hermeticitetin e bokaportave të rezervuarit, Gjatë ngarkimit të autocisternave, për asnjë rast tubi i ngarkimit të mos jetë mbi lartësinë e caktuar nga fundi i cisternës.
9. Me qenë se Parku i rezervuarëve, do të magazinojë karburante të tillë si mishela dhe gazi i lëngshëm, masat për mbrojtje ndaj zjarrit duhet të jenë tepër të larta. Ato janë tre si impiant impiantar për MNZ, impiant gjysmë impiantar dhe impiante të lëvizshëm.